

V E N D I M

Nr.65, datë 11.2.1993

PER ORGANIZIMIN E LLOTARIVE, TE KONKURSEVE PARASHIKUESE DHE TE LOJRAVE TE TJERA TE FATIT

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë,
Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë drejton dhe kontrollon veprimtarinë e llotarive, të konkurseve parashikuese dhe të lojrave të tjera të fatit.
2. Të drejtën e organizimit e të ushtrimit të veprimtarisë së llotarive, të konkurseve parashikuese, për lojrat e fatit me makina automatike elektronike e kanë personat juridikë shtetërorë ose privatë, vendas a të huaj, ose dhe me pjesëmarrjen e kapitalit të huaj, pasi marrin licencën nga Komiteti i llotarive dhe konkurseve parashikuese.
3. Të drejtën e organizimit dhe të ushtrimit të veprimtarisë së kazinosë dhe lojrave të tjera të ngjashme me të e kanë të gjithë personat juridikë shtetërorë ose privatë, vendas a të huaj, ose edhe me pjesëmarrjen e kapitalit të huaj, pasi marrin licencën nga Komiteti i llotarive e konkurseve parashikuese. Kjo licencë jepet për një periudhë kohe deri në dy vjet. Me mbarimin e afatit 2-vjeçar licenca mund të ripërsëritet.
4. Pjesëmarrja e shtetasve në llotaritë, në konkurset parashikuese dhe në lojrat automatiko-elektronike bëhet në çdo rast kundrejt blerjes (ose pagesës) prej tyre të dokumentit përkatës, që përbën letër me vlerë e që lëshohet në qarkullim nga personi juridik shtetëror, privat, ose me pjesëmarrjen e kapitalit të huaj, për llotaritë e konkurset parashikuese dhe lojrat e fatit automatikoelektronike. Dokumenti përkatës që përbën letër me vlerë, miratohet nga Komiteti i llotarive dhe konkurseve parashikuese.
5. Pranë Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë të

krijohet Komiteti për llotaritë dhe konkurset parashikuese me këto detyra:

- a) Shqyrton e miraton kërkesat për dhënien e licencave për ushtrimin e veprimtarive të llotarive, konkurseve parashikuese, lojrave të fatit automatiko-elektronike e kazinove dhe të përcaktojë rregullat e kushtet për lëshimin e licencave.
- b) Të caktojë llojin dhe vleftën e letrave me vlerë ose për ato që bëhen me vlerë gjatë zhvillimit të veprimtarive.
- c) Të përcaktojë kriteret e shpërndarjes së të ardhurave nga llotaritë, konkurset parashikuese, lojërat e fatit automatiko-elektronike dhe në veçanti për kazinotë.
- ç) Të ushtrojë kontroll të veçantë mbi veprimtarinë e kazinove.
- d) Të miratojë rregulloren e zhvillimit të llotarive, konkurseve parashikuese dhe lojrave të fatit automatiko-elektronike.

6. Komiteti i llotarive e konkurseve parashikuese vepron për një kohë prej 4 vjetësh dhe përbëhet nga 9 deri në 11 anëtarë. Anëtarë të këtij komiteti të jenë specialistë të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, si dhe specialistë të tjerë që nuk janë në marrëdhënie pune me këtë ministri. Ministri i Financave dhe i Ekonomisë që është kryetar i këtij komiteti, cakton anëtarët dhe numrin e tyre.

7. Mënyra e funksionimit të Komitetit përcaktohet në rregulloren e tij.

8. Për zhvillimin, organizimin dhe administrimin e llotarive dhe konkurseve parashikuese të krijohet Qendra Kombëtare e Llotarive dhe Konkurseve, e cila do të varet nga ministri i Financave dhe i Ekonomisë dhe do ta ushtrojë veprimtarinë në bazë të rregullave të përcaktuara prej tij.

9. Shkelja e rregullave të caktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi, kur nuk formon vepër penale, dënohet si kundërvajtje administrative nga punonjësit e Policisë Financiare, sipas dispozitave të ligjit "Për policinë financiare".

10. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.348, datë 20.9.1991 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE
ALEKSANDER MEKSI